



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 513, datë 24.09.2024

**PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 294, DATË 30.05.2023 “PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES
SË KANDIDATËVE PËR LËVIZJE PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS
SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË E DURRËS
PËR POZICIONET E SHPALLURA TË LIRA, PËRKATËSISHT ME VENDIMET
NR. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 DHE 24, DATË 18.01.2023 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IV dhe V të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, vendimin nr. 361, datë 29.07.2024 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban Toro”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 294, datë 30.05.2023, “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nënpika “b” si më poshtë:

Caktimin e z. Albens Tabaku si relator për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 24.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij projektvendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR